

OBJEKTI

SISTEMIM ASFALTIM "RRUGA VUKPALAJ"

RELACION TEKNIK



VITI 2019

RELACION TEKNIK

MBI PROJEKT ZBATIMIN E OBJEKTIT:

SISTEMIM ASFALTIM “RRUGA VUKPALAJ”

Projekti është studiuar, hartuar dhe përpunuar në bazë të Detyrës së Projektimit të dhënë nga Bashkia Malesi e Madhe, dhe Kushteve Teknike të Studimit e Projektimit të Rrugeve, Kanalizimeve si dhe disa referenca projektesh të zbatuara nga FSHZH në zonat rurale.. Nevoja e ndërhyrjes në këtë rrugë bëhet e domosdoshme për shkak të gjendjes ekzistuese. Shtresat ekzistuese të asfaltit janë dëmtuar ose mungojnë. Kjo rrugë shërben për një zonë të urbanizuar vitet e fundit ku është shtuar numri i familjeve që kanë ndërtuar shtëpi. Si zonë e urbanizuar vitet e fundit, ku shtëpitë e ndërtuara janë futur pothuajse në proces legalizimi, bëhet e domosdoshme ndërhyrja me investime në infrastrukturë.

PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE.

Për hartimin e projektit të kësaj rruge në radhë të parë u inspektua gjendja ekzistuese e rrugës dhe të gjithë elementeve të infrastrukturës që lidhen me rrugën. Rruga nuk është e shtruar me asfalt. Gjithashtu shtresat e zhavorrit në segmentet e tjera janë të dëmtuara. Gjatë ditëve me shi, gropat e rrugës mbushen me ujë dhe me gjithë zhavorrin e shtruar para shumë kohësh balta është prezente në rrugë, gjë që bën të vështirë kalimin në këmbë i banoreve si dhe të mjeteve. Gjatë ditëve me diell dhe me mot të thatë prezenca e pluhurit është përetj kufijve të lejuar të ndotjes. Gjatë inspektimit kemi dëgjuar ankesat e banoreve për ndotjen e ajrit nga ujrat e zeza të cilat në shumicën e kohës dalin në sipërfaqe. Kjo rrugë e ka pikën e nisjes tek lagja Vukpalaj-Bajze e shkon në drejtim të fshatit Vukpalaj. Kjo rrugë intersektohet me rrugën nacionale Shkoder Hani Hotit. Me qartë kjo duket në planin e përgjithshëm të rrugës dhe fotot si më poshtë.

KRYERJA E MATJEVE TOPOGRAFIKE

Për këtë rrugë është bërë marrja e leximeve topografike duke përdorur total station. Gjatë këtij procesi janë shënuar të gjitha objektet e dukshme si muret rrethuese të shtëpive, shtyllat elektrike të tensionit të lartë dhe të ulët. Në muret e rrethuese janë shënuar disa prej pozicioneve të profileve të lexuara në terren. Përveç ketyre janë shënuar edhe ndërtesat në të dy anët e rrugës. Kuota e pikës së fillimit të rrugës CS-01 është 26.98m. Kuotat e pikës së fundit CS-121 është 50.02m. Kuota më të ulët e më të lartë të kësaj rruge janë po pikërisht në këto piketa, CS-01 dhe CS-121.

TRUPI I RRUGES

1.PROJEKTIMI I PROFILIT TERTHOR TE RRUGËS.

Mbeshtetur në detyrën e projektimit dhe në faktin se kjo rrugë do t'i shërbejë një zone të banuar në zhvillim rrugën e kemi projektuar, sipas porosisë që në këtë fazë do të bëhet nderhyrje me paket të plotë shtresash. Pjesa kaluese e rrugës do të ruajë karakteristikat ekzistuese, në lidhje me aksin, por do të ketë përmirësime të ndjeshme të profilit gjatësor, profilit terthor, të dhënave planimetrike e altimetrike për rrezet, etj. Gjerësia e rrugës e asfaltuar është 3.5 m dhe me dy bankina djathtas dhe majtas me nga 0.5 m. Pra gjerësia totale e rrugës është 4.5 m. Pjerresia terthore e rrugës është projektuar me pjerresë terthore të dyanëshme me 2.5%. Lidhja e aksit kryesor të rrugës me kalime dytesore me gjatësi rreth 2 deri 5 m secili, të cilat përveç rakordimit të rrugës me dalje anësore e mbron këtë rrugë dhe nga dëmtimet e ndryshme për shkak se rrugët dytesore janë të pashtuara.

2.SHTRESAT E RRUGES.

Projekti ka parashikuar nderhyrjen në rrugën ekzistuese duke e skarifikuar asfaltin dhe shtresat e dëmtuara. Atje ku bazamenti i saj është i dëmtuar do të bëhet mbushja me një shtresë zhavorri minimumi 20 cm të trashë e cila do të mbushet me shtresë dhe do të ngjishet, Rruga në të gjithë gjatësinë e saj prej 1200 m (të dy segmentet) do të ketë si shtresë asfaltike 6 cm binder. Në të do të vendoset 10 cm stabilizant me përberës sipas specifikimeve teknike dhe shtresë e zhavorrit 20cm. Kështu me konkretisht do të kemi :

3.KULLIMI I UJRAVE TE SHIUT.

Kullimi dhe sistemimi i ujrave sipërfaqesore në të gjithë gjatësinë e segmentit rrugor do të bëhet me anë të pjerresis së asfaltit dhe bankinave drejt zonave anësore të saj. Pjesa më e madhe e kësaj rruge ujrë të shiut të nxjerrë në dy anë të rrugës në natyrë të hapur, apo kanal që ekzistojnë aty pranë saj.

4.BANKINAT

Parashikohet që gjerësia e bankinave të jetë 0.5 metra. Kjo pjesë e rrugës nuk do të asfaltohet, por shërben në rast të ndërrimit të dy mjeteve. Pjerresia e bankinave është 10 %. Në zonat ku rruga do të ketë degezime bankinat do të ndërpriten. Projekti ka parashikuar për ndërtimin e tij shtresat: mbushje me zhavorr, cakell të fraksionuara 10cm. Supervizioni i objektit me autoritetin kontraktues mund të parashikojë ndërtimin e segmenteve me trotuar në njërën anë në momentin kur zbatohet objekti.



KANALIZIMET E UJRAVE TE ZEZA

Në këtë ndërrim nuk parashikohen punime për kanalizime

UJESJELLESI

Në këtë ndërrim nuk parashikohen punime për ujësjellësin

Projekti përmban:

1. Topografia e gjendjes ekzistuese me kuota, izohipse dhe pika referimi.
2. Planimetritë e rrugës, në të cilën pasqyrohet orientimi i piketazhit të përdorur dhe baza e kuotes relative nga e cila janë bazuar të gjitha matjet topografike të kryera. Në planimetri janë dhënë kufizimet me rrugën ekzistuese me muret që kanë ndërtuar banorët .
3. Planimetria e shpronësimeve me të cilën dalin në dukje sipërfaqet që duhen liruar për të zgjeruar rrugën sipas gjerësisë së parashikuar në projekt. Projekti është hartuar për të mbërritur më një të mirë optimale të pranueshme për zhvillimin në perspektivë të kësaj zone të banuar.

4. Profilat terthore ne shkalle 1:50, ku percaktohen ne menyre te detajuar gjeresia e aksit rrugor ne çdo pike te profilit gjatesor, sipas piketazhit, e cila eshte projektuar 5 m, me pjerresi terthore 2.5%.
5. Profilat terthor tip te rruges si dhe profilat terthor per cdo seksion .
6. Profilat gjatesor ne aks per rrugen ne shkalle vertikale 1:100 dhe horizontale 1:1000, ku percaktohen pjerresite gjatesore sipas kushteve teknike, kuotat, distancat pjesore e progresive shoqeruar me piketazhin perkates dhe elemente te tjere.

Projekti eshte i detajuar per zbatim sipas kushteve teknike te ndertimit te rrugeve duke i u pershtatur ngarkesave automobilistike ne zonat rurale.

Preventivi i zbatimit.

Nga perpunimi dhe perlllogaritja e fleteve te projektit rezulton se per zbatimin e objektit do te kryhen keto volume kryesore:

Per zerat e punes qe jane parashikuar ne projekt preventiv jane pergatitur specifikimet teknike qe shoqerojne projektin.

Nga vleresimi i punimeve te ndertim montimit per te gjithë objektin me çmimet e manualeve rezulton qe vlere e plote eshte **14,999,984 leke** .

PROJEKTUESI

LENI-ING shpk

